

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ADNAND XHELILI

02/12/2020

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 31.01.2020 për subjektin e rivlerësimit, Adnand Xhelili, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, në datën 12.2.2020, vendosi: Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Xhelili, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga z. Olsi Komici, znj. Firdes Shuli relatore, znj. Brunilda Bekteshi anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.